



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:080530

Datë: 25.07.2022

Numri i dokumentit: 03259741

P.nr.63/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC/Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me bashkëpunëtorin profesional Afrim Gashi, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit Q. K. nga fshati Pastaselë, komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale dhuna në familje nga neni 248/1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Gjakovë / Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.211/22, të datës 16.04.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, në prezencën e përfaqësuesit të akuzës Prokurorit të Shtetit Qazim Xharra, të akuzuarit dhe të dëmtuarës, më datë 12.07.2022, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

Q. K., nga i ati H. dhe e ëma E., e lindur Th., i lindur më ..., në fshatin Pastaselë, komuna e Rahovecit, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, i ati i dy fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e:

Nga data e pa vërtetuar e gjer me datën 30.01.2022, rreth orës 08:30 minuta, në fshatin Pastaselë, komuna e Rahovecit, saktësisht në shtëpinë e tyre të përbashkët, i pandehuri Q. K., me dashje me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënie familjare në mënyrë sistematike ushtron dhunë në familje, gjegjësisht keqtrajtimin fizik dhe psikologjik ndaj të dëmtuarës-bashkëshortes së tij V. I., në atë mënyrë që e kanos disa herë se “do të vras”, “të mbys”, “ti nuk duhet të flasësh”, me datë 29.01.2022 pas një mosmarrëveshje për djalin, i pandehuri e sulmon fizikisht duke e kapur për fyti dhe rrezuar në tokë, ndërsa në ditën kritike bashkëshortja e tij derisa ishte duke i bartur disa drunjë për ta nderuar zjarrin, i pandehuri-bashkëshorti i saj Q. ia ka kërkuar çelësat e veturës dhe për pamundësi për tija dhënë çelësat

sepse i kishte duart e zëna me drunjë, e sulmon fizikisht duke e kapur për flokë dhe e rrezon për tokë, me çka tek e dëmtuara ka shkaktuar frikë, dhembje dhe shqetësim emocional.

-me çka ka kryer veprën penale dhuna në familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të neneve 4, 6, 7, 17, 38, 39, 40 par. 1 nënpar.1.2 dhe 1.3, 42, 43, 44, 69, 70, nenit 329 par.1 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit ia shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **dyqind (200) euro**, si dhe

DËNIM ME BURGIM NË KOHËZGJATJE prej një (1) **muaj**.

Pasi që gjykata ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) **muaji**, i akuzuari ka dhënë pëlqimin që dënimi me burgim të zëvendësohet në dënim me gjobë.

Gjykata me pëlqimin e të dënuarit në kuptim të nenit 44 të KPRK-së, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1) muaji, ia zëvendëson me gjobë në shumë prej **dyqind (200) euro**.

Gjykata duke u bazuar në nenin 76 paragrafi 1 nën paragrafi 2.4 të KPRK-së, lidhur me bashkimin e dënimit me gjobë, të akuzuarin e:

G J Y K O N

ME DËNIM ME GJOBË në shumë të përgjithshme prej katërqind (400) euro.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në shumë prej pesëqind (500) €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në kuptim të nenit 43 të KPRK-së, atëherë të akuzuarit, dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgimi në kohëzgjatje prej njëzet (20) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga njëzet (20) euro.

E dëmtuara V. I. nga fshati Pastaselë, komuna e Rahovecit, ka hequr dorë nga kërkesa për kompensim dëmi.

Detyrohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej tridhjetë (30) euro, si dhe për fondin e kompensimit të viktimave të krimit shumë prej tridhjetë (30) euro e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.211/22 të datës 16.04.2022, kundër të akuzuarit Q. K. nga fshati Pastaselë, komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale dhuna në familje nga neni 248/1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 12.07.2022, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Qazim Xharra, i akuzuari dhe e dëmtuara.

Prokurori i shtetit Qazim Xharra, gjatë shqyrtimit fillestar ka lexuar aktakuzën duke qëndruar në tërësi pranë saj.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të pranojë ose të mos e pranojë fajësinë, si dhe e ka njoftuar lidhur me efektet dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

I akuzuari ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas të gjithave pikave të aktakuzës, e ndjen veten fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet dhe se ndjen keqardhje për rastin që ka ndodhur, pendohet për veprimin e bërë, kërkon falje nga i dëmtuari dhe i premtun gjykatës se një veprim i tillë nuk do të përsëritet.

I akuzuari Q. K., ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, e ndjen veten fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet dhe se ndjen keqardhje për rastin që ka ndodhur, i premtun gjykatës se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe sot e kësaj dite jeton me bashkëshorten dhe fëmijët e tyre, si dhe i propozoj gjykatës që të ketë mirëkuptim në shqiptimin e dënimit, në rast se gjykata i shqipton dënim me burg i propozoj gjykatës që të zëvendësohet me dënim me gjobë.

E dëmtuara V. I. nuk e ka kundërshtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, këtu bashkëshortit të saj, me të akuzuarin prej ditës kritike nuk kanë kurrfarë problemi dhe bashkëjetojnë, ndaj të akuzuarit nuk ju ka bashkëngjitur ndjekjes penale si dhe nuk ka kërkuar kompensimin e dëmit.

Prokurori i Shtetit Qazim Xharra e ka dhënë mendimin lidhur me pranimin e fajësisë i cili ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnet të lirë dhe pasi i ka kuptuar të drejtat, respektivisht favorët dhe pasojat e pranimit të fajësisë, po ashtu duke marrë për bazë se aktakuza ka mbështetje në provat materiale dhe personale në bazë të të cilave është paraqitur gjendja faktike në dispozitiv të saj, ku edhe përmbushen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën ngarkohet i akuzuari. Andaj, i propozoj gjykatës që ta aprovojë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata duhet të ketë parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, pendimin për veprimin e bërë prej ditës kritike nuk kanë probleme, mirëpo e lë në vlerësim të gjykatës për rrethanat rënduese të cilat gjenden në lëndë. I propozoj gjykatës që i akuzuari të obligohet në shpenzimet procedurale.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë

pranimet të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimet të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPPK-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: - se i akuzuari Q. K. nga fshati Pastaselë, komuna e Rahovecit, me dashje ka kryer veprë penale dhuna në familje nga neni 248/1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 248 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale dhuna në familje e kryen: “ **Kushdo që e kryen ose keqtrajtimin fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.**

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin Q. K. e ka shpallur fajtor sipas aktakuzës së lartcekur, ngase në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale dhuna në familje nga neni 248/1 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që edhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij dhe gjendjen e tillë faktike e mori ashtu sikurse ishte përcaktuar në aktakuzë dhe provat të cilat i përmbante aktakuza, e të cilat janë:

- Raportin e oficerit policor D. K., KPS# ... i datë 31.01.2022;
- Deklarata e të dëmtuarës V. I. e dhënë pranë Stacionit Policor në Rahovec me dat 30.01.2022;
- Deklarata e të dëmtuarës V. I. e dhënë pranë P.Th në Gjakovë, me datën 09.02.2022;
- Deklarata e të pandehurit Q. K., e dhënë pranë Stacionit Policor në Rahovec me dat 30.01.2022
- Fotografit e dokumentacionit si dhe shkresat tjera në lëndë, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata ka vendosur ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: se është i gjendjes së varfër ekonomike, pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese nuk gjeti. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, dhe këto dënime si i tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën

penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarëst që kërkesën pasurore – juridike ta realizojë në procedurën e rregullt civile, bazohet në nenin 463 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor bazohet në nenin 453 par.1 të KPPK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në kuptim të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr.05/L – 036, për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr.63/2022, me datë 12.07.2021

B. profesional
Afrim Gashi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Mizahir Shabani

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.